



2-17018158
30.09.2022

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/180/27

Datë: 30.09.2022

Në bazë të nenit 61 paragrafi 2 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Ligji Nr. 03/L-048); nenit 40 paragrafi 2 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 21 paragrafi 21.1 pika e) të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 19 paragrafi 15 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e tij të jashtëzakonshme të mbajtur me 30.09.2022 nxjerrë:

V E N D I M

për miratimin e Buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2023

I. Me këtë vendim miratohet Buxheti i Komunës së Junikut për vitin 2023 i propozuar nga Kryetari i Komunës së Junikut, dhe Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025.

II. Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Junikut për vitin 2023 është: **1,877,346.00 €** dhe është i shpërndarë në linjat buxhetore si në vijim:

1. Staf i për vitin 2023, është **167 punëtorë**.
2. Kategoria Paga dhe mëditje për vitin 2023, është : **1,170,906.00 €**
3. Kategoria Mallra dhe shërbime për vitin 2023, është **236,740.00€**
4. Kategoria e Shpenzimeve komunale për vitin 2023, është **37,700.00 €**
5. Kategoria e Subvencioneve për vitin 2023, është **52,000.00 €**
6. Kategoria e Shpenzimeve kapitale për vitin 2023, është **380,000.00€**

Totali i Buxhetit të aprovuar për vitin 2023, është 1,877,346.00 €

III. Komuna e ka bërë planifikimin duke respektuar kufijtë e Qarkores buxhetore 2023/02 për Komuna.

IV. Për zbatimin e këtij vendimi respektivisht ekzekutimin e buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2023 sipas linjave buxhetore nga pika II e këtij vendimi është përgjegjës Kryetari i Komunës së Junikut.

V. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet tjera me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në web faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

VII. Vendimi iu dërgohet:

1. Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal,
2. Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve
3. Kryetarit të Komunës,
4. Shërbimit të Kuvendit të Komunës së Junikut,
5. Arkivës të Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Shpejtim Gacaferi

